



REPUBLIKA E KOSOVES-VLADA / QEVERIA E KOSOVES	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njesia Org.	5
Org. Jedinica	5
Org. Unit	5
Nr. i faqeve	2
Br. stranica	2
No. pages	2
Nr. Prot.	1833
Prot. No.	1833
Data	12.10.22
Date	12.10.22
Prishtine / e	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë:

Nr.

Komisioni për Licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 1833 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga BPrAL-Kolegji “UBT” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet në nivel institucional, BPrAL - Kolegji “UBT” Sh.p.k, rr. “ Bill Klinton” p.n. Prishtinë, bazuar në vendimin e KSHC nr. 656/22 datë 19.05.2022 për periudhën kohore nga 1 tetori 2022 – 30 shtator 2025.
2. Licencohet në nivel institucional, BPrAL - Kolegji “UBT” dega në Prizren dhe Ferizaj sipas vendimit nr. 980/20D i datës 21.07.2020 për periudhën kohore nga 1 tetori 2020 deri me 30 shtator 2023.
3. Nuk licencohet në nivel institucional BPrAL – Kolegji “UBT” dega në Gjilan bazuar në vendimin e KSHC nr. 954/22 datë 18.07.2022.
4. Licencohet BPrAL – Kolegji “UBT” në nivel të programeve të akredituara nga KSHC bazuar në vendimet: nr. 1037/22 datë 02.08.2022; nr. 1038/22 datë 02.08.2022; nr. 657/22 datë 19.05.2022; nr. 953/22 datë 18.07.2022; nr. 955/22 datë 18.05.2022; për periudhën kohore nga 1 tetori 2022 – 30 shtator 2025.
5. Nuk licencohet BPrAL – Kolegji “UBT” në nivel të programeve bazuar në vendimet e KSHC : nr. 39/22 datë 10.01.2022; nr. 40/22 datë 10.01.2022; nr. 41/22 datë 10.01.2022; nr. 42/22 datë 10.01.2022; nr. 43/22 datë 10.01.2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për Licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1833 i datës 21.07.2022, të parashtruar nga Kolegji “UBT”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim dhe rilicencim në nivel institucional dhe të programeve duke u mbështetur në vendimet e KSHC-së të shënuara në dispozitivin e këtij vendimi.

Licenca në nivel institucional e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025) sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim/ KSHC-së.

2. Licencohet në nivel institucional, BPrAL - Kolegji “ UBT ” dega në Prizren dhe Ferizaj sipas vendimit nr. 980/20D i datës 21.07.2020 për periudhën kohore nga 1 tetori 2020 deri me 30 shtator 2023.

Ndërkaq, kohëzgjatjet e licencimit në nivel të programeve bazohen sipas vendimeve të AKA / KSHC-së, të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e paraqitura në dokumentacionin për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Komisionit për licencim;
4. DALSHT;
5. Qendrës NARIC;
6. Inspektoratit të Arsimit;
7. Arkivit.

